

**“ B E Q I R I “ Sh.p.k**  
Shenime Shpjeguese

---

**SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE**

**“ B E Q I R I “ Sh.p.k**

**Për Periudhen 01.01. 2020 - 31.12.2020**

(Të gjitha balancat janë në lekë)

**Sqarim:**

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 2.

Plotesimi i te dhenave të kësaj pjese duhet të bëhet sipas kërkesave dhe strukturës standarte të percaktuara ne SKK 2 dhe konkretisht paragrafeve 49-55. Rradha e dhenies se spjegimeve duhet te jete :

- a) Informacion i përgjithshëm dhe politikat kontabël
- b) Shënimeve qe shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare
- c) Shënime të tjera shpjeguese

**A I : Informacion i përgjithshëm**

1. Kuadri ligjor: Ligjit 9228 dt 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"

2. Kuadri kontabel i aplikuar : Stndartet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiperi.(SKK 2; 49)

3. Baza e pergatitjes se PF : Te drejtat dhe detyrimet e konstatuara.(SSK 1, 35)

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlllogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

4. Parimet dhe karakteristikat cilesore te perdorura per hartimin e P.F. : (SKK 1; 37 - 69)

a) **NJESIA EKONOMIKE RAPORTUSE** ka mbajtur ne llogarite e saj aktivet, pasivet dhe transaksionet ekonomike te veta.

b) **VIJIMESIA** e veprimtarise ekonomike te njesise sone raportuse eshte e siguruar duke mos pasur ne plan ose nevoje nderprerjen e aktivitetit te saj.

c) **KOMPENSIM** midis nje aktivi dhe nje pasivi nuk ka , ndersa midis te ardhurave dhe shpenzimeve ka vetem ne rastet qe lejohen nga SKK.

d) **KUPTUSHMERIA** e Pasqyrave Financiare eshte realizuar ne masen e plote per te qene te qarta dhe te kuptueshme per perdorues te jashtem qe kane njohuri te pergjitheshme te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.

e) **MATERIALITETI** eshte vleresuar nga ana jone dhe ne baze te tij Pasqyrat Financiare jane hartuar vetem per zera materiale.

f) **BESUSHMERIA** per hartimin e Pasqyrave Financiare eshte e siguruar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e mepostheme :

- Parimin e paraqitjes me besnikeri
- Parimin e perparetise se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore
- Parimin e paaneshmerise pa asnje influencim te qellimshem
- Parimin e maturise pa optimizem te teperuar, pa nen e mbivleresim te qellimshem
- Parimin e plotesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te PF.
- Parimin e qendrushmerise per te mos ndryshuar politikat e metodat kontabel
- Parimin e krahasushmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

**“ B E Q I R I “ Sh.p.k**  
**Shenime Shpjeguese**

---

**A II: Politikat kontabël**

**1.Mjetet monetare** ne arke dhe ne banke jane vleresuar me Vleren e Drejte( SKK 3)  
Monedhat e huaja jane vleresuar ne monedhen leke ne fund te periudhes me Kursin Zyrtar  
Kurset e Kembimit me 31.12.2020 jane **1 euro = 123.70 All dhe 1 usd = 100.84 All .**

**2.Aktive te tjere financiare** jane regjistruar ne bilace me koston e amortizuar(SKK 3)  
(Ne pergjithesi eshte e barabarte me vleren nominale te kereses per arketim minus zhvleresimin)

**3.Inventari** Per percaktimin e koston se inventareve eshte zgjedhur metoda hyrja e pare dalje e pare .  
( SKK 4 : 15 )

**4.Aktivet Afatgjate Material**

Vleresimi fillestar i nje elementi te AAM qe ploteson kriteret per njohje si aktiv ne bilanc  
eshte vleresuar me kosto. (SKK 5; 11)

Per vleresimin e mjetit te blere me qera financiare eshte perdorur Vlera e drejte (SKK 7)

Per prodhimin ose krijimin e AAM kur kjo financohet nga nje hua,kostot e huamarrjes (dhe  
interesat) eshte metoda e kapitalizimit ne koston e aktivit per periudhen e investimit.(SKK 5: 16)

Per vleresimi i mepaseshem i AAM eshte zgjedhur modeli i koston duke i paraqitur ne  
bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar. (SKK 5; 21)

Per llogaritjen e amortizimit te AAM (SKK 5: 38) njesia jone ekonomike ka percaktuar  
si mtode te amortizimit te ndertesave metoden lineare dhe per AAM te tjera metoden e amortizimit mbi  
bazen e vlefes se mbetur ndersa normat e amortizimit jane perdorur te njellojta me ato te sistemit ne fuqi  
dhe me konkretisht :

**5.Huat dhe obligacionet afatshkutra** jane vleresuar me koston e amortizuar (SKK 3)

Huat dhe Parapagimet jane vleresuar me koston e amortizuar (SKK 3)

**6.Huat afatgjata** jane vleresuar me koston e amortizuar (SKK 3)

Per kontabilizimin e qerases financiare eshte perdorur ( SKK 7)

**7.Shitjet Neto** Te ardhurat e perfituara nga shitja e produkteve,mallrave dhe sherbimeve gjate periudhes  
kontable jane vleresuar sipas SKK 8 te ardhurat

Te ardhura teTjera ;jane te ardhura qe perftohen jo rregullisht gjate veprimtarise normale

**8. Transaksionet në monedhë të huaj** konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci,zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e koston historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

**“BEQIRI“ Sh.p.k**  
**Shenime Shpjeguese**

---

• **SHENIME TE TJERA SHPJEGUESE**

**1.Transaksione te Paleve te Lidhura :** Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksione dhe marredhenie te mundeshme, jo thjesht formen ligjore te tyre , veç huase se marre nga ortaku nuk ka transaksione te tjera me palet e lidhura.

**2.Ngjarje pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit :** Asnje ngjarje e rëndesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare. Nga analiza e gjendjes dhe performances financiare te shoqerise, rezulton se ne vitin ushtrimor 2020 eshte ulur shifra e afarizmit dhe eshte rritur fitimi tregtar.

**3.Shifrat Krahasuese :** Shifrat krahasuese te deklaruar ne pasqyrat financiare 2020 jane riklasifikuar per tu pershtatur prezantimit te pasqyrave financiare te vitit actual, te cilat jane ndertuar sipas SNK-ve qe aplikohen per here te para dhe ne menyre prospektive.

**Hatuesi i Pasqyrave Financiare**

**DERVISH BEQIRAJ**



**Drejtuesi i Njesise ekonomike**

**NEIM BEQIRAJ**

